



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_312_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_451_09_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_451_09_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Milivoje Radulović (parashtruesi i ankesës Berat Lahu, shifra e konsumatorit DPR – 105035) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 03.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 30.01.2009 duke kundërshtuar borxhin paraprak të bërë nga persona tjerë.

- Me datë 12.02.2008 konsumatori Berat Lahu ka nënshkruar kontratën për shitblerje së banesës me ç'rast ka ble një banesë nga një serb me emrin Milivoje Radulović, e cila kontratë është edhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Provë: Kontrata e shitblerjes së banesës me datë 12.02.2008

- Konsumatori me datë 07.10.2004 ka marrë nga Agjensioni Kosovar i Pronave (më herët Drejtorati për çështje pronësore dhe banesore) Protokolin mbi dorëzimin e çelësave ku edhe iu është bërë dorëzimi i çelësave të banesës.

Provë: Protokoli mbi dorëzimin e çelësave nga AKP

- Me datë 10.10.2008 konsumatori ka marrë nga Agjensioni Kosovar i Pronave një kërkesë e cila iu është drejtuar KEK-ut lidhur me shqyrtimin e shpenzimit të energjisë. Në këtë kërkesë theksohet se z. Milivoje Radulović është vendosur në pronën e tij në adresë Dardanija, Blloku-1, hy.1, LI-1, nr. 11, Prishtinë si pronar i ligjshëm. Me këtë datë ai ka k137rkuar që të shqyrtohet rasti i tij sepse shpenzimet e energjisë elektrike i ë pronën e lartë cekur pohon se janë bërë nga z. Hamdi Aliu i cili ka banuar në banesë deri më 07.10.2004 dhe mendojmë se ky shpenzim duhet të hiqen deri në datën e cekur.

Provë: Kërkesa për rishqyrtimin e shpenzimit të rrymës nga AKP

- Me datë 11.11.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK – Departamentin për Konsumatorë lidhur me shlyerjen e borxhit duke u bazuar në të gjitha dokumentacionet relevante nga KPA.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e njoftuar se sipas protokollit mbi dorëzimin e çelësave pronarit të ligjshëm të datës 07.10.2004 të pranuar nga KAP mund ti adresohen shfrytëzuesit të mëparshëm, duke u bazuar sipas urdhëresës administrative UNMIK/DIR/2008/5. Për periudhën 07.10.2004 e deri 12.02.2008 pronari i ligjshëm e ka poseduar pronën dhe gjithmonë duke u bazuar në dokumentet e ofruara ngase nuk ka dëshmi tjera.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 30.01.2009
- Me datë 03.02.2009 konsumatori iu është drejtuar DMK-së në ZRRE me një ankesë lidhur me shlyerjen e borxhit.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 02.09.2010 DMK në ZRRE pas analizës së bërë lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK_V_451_09_10 duke **pranuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK:
 1. Konsumatori Berat Lahu tani pronar i ligjshëm i banesës në rrugën “Xhemajl Mustata”, BB-1, hy.1, nr.10, Dardani, Prishtinë të mos ngarkohet nga ana e KEK-ut për borxhin e krijuar nga persona tjerë.
 2. Agjensioni Kosovar për Prona duhet të siguroj të dhëna KEK-ut lidhur me pronarin jo-legal që e ka shfrytëzuar banesën.
 3. Shuma e ngarkuar nga ana e KEK-ut deri me datën 03.03.2008 e cila është në shumë prej 3,278.81 €, duhet të shkarkohet nga transaksioni i konsumatorit (kartela e konsumatorit) me shifër DPR – 105035.
 4. Tani shifra DPR - 105035 të regjistrohet në emër të konsumatorit të ligjshëm dhe që të faturohet me emër të ri.
 5. Konsumatori obligohet që pjesën e faturave pas periudhës 03/2008 të paguajë KEK-ut.
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK-së në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Apelimi i KEK-ut i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_451_09_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi shtesë, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK_V_451_09_10**.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimt të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar